

Bashkia Himare; Deklarata e Misionit Strategjik



BASHKIA HIMARE

NJESIA E MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Adresa: Bashkia Himare Spile-Himare. Tel: 0393-2355. Fax: 0393-2355. E-mail: bashkiahimare@yahoo.com

Nr.ext.Prot.

Himare, me,11/01/2016

DEKLARATA E MISIONIT STRATEGJIK TE BASHKISE HIMARE 2016 – 2020

Kjo deklarate mbështetet ne legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe aktet nenligjore dhe ne Strategjia Kombetare Ndersektoriale per Decentralizimin e Qeverisjes Vendore per vitet 2015-2020. Kjo Deklarate prezanton ne menyre te permbledhur, një përfaqje gjithëpërfshirëse ndaj decentralizimit dhe forcimit të qeverisjes vendore, konkretisht te Bashkia Himare, në përputhje me parimet e Kartës Evropiane për Vetë-Qeverisjen, me synim sigurimin e decentralizimit politik, administrativ dhe fiskal.

Bashkia Himare, e krijuar sipas Ligjit nr.115 date 31.7.2014, per Reformen Territoriale ne Shqiperi, ka nje territor prej rreth; 572 km² dhe perbehet nga 24 fshatra dhe qendra banimi te inkuadruara brenda tri Njesive Administrative-Territoriale qe jane; Himara si Qender me fshatrat e saj, Lukova me fshatra dhe Hore-Vranisht me fshatra. Sipas Rregjistrimit Kombetar te Gjendjes Civile, ka nje popullsi te pergjitheshme me rreth 30,000 banore, dhe nje popullsi rezidente me afersisht; 17,000 banore.

Ligji themelor me te cilin organizohet dhe funksionon Bashkia eshte Ligji nr.139 viti 2015 "Per vetqeverisjen vendore". Legjislacioni ne fuqi percakton tre lloje kompetencash (funksionesh) per Bashkine: a- *funksionet e veta*, b- *të përbashkëta dhe* c- *të deleguara*. Misioni i Bashkise; në drejtim të zbatimit të funksioneve të përbashkëta eshte në sistemin e arsimit, shërbimeve sociale dhe mbrojtjen e rendit e te sigurisë publike, te cilat, pergjithesisht jane transferuar ne Bashki. Ne vijim do te transferohen edhe funksionet, sic jane ato që lidhen me mjedisin dhe trashëgiminë kulturore dhe me vone; zbatimi i funksioneve të përbashkëta me drejtim në shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor etj. Ne objektivat tona do te jete; përmbyllja e procesit të decentralizimit të kompetencave në funksionet e përbashkëta dhe të deleguara me qeverisjen qendrore, ne qender te se ciles eshte transferimi i funksioneve te tjera. Ndarja e përgjegjësive dhe te kompetencave në funksionet e përbashkëta dhe të deleguara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore, bazohet në parimin e subsidiaritetit.

Misioni ka ne themel; Drejtimet, Aktivitetet dhe Veprimtarite kryesore te Bashkise Himare, jane zhvillimet pa nderprerje dhe me progres, ekonomike, shoqerore dhe sociale dhe ngritjen e mirqenies komunitare nepermjet rritjes se vazhdueshme te t'ardhurave nga sektoret prodhues, te tregetise e te sherbimeve si dhe rritjes se investimeve publike. Thithja e sa me shume investitoreve, vendas dhe te huaj, ne kushtet e legjislacionit dhe shfrytëzimi i resurseve e potencialeve qe ka territori, per te zhvilluar me rritme me te shpejta infrastrukturen dhe sidomos; t'ardhurat qe vijne nga industria e turizmit.

- Vizioni, përparësitë dhe qëllimet strategjike, eshte plani afatgjatë i Bashkise, përfshirë këtu përgjegjësitë dhe funksionet, autoritetin, instrumentet dhe burimet financiare, si edhe përgjegjshmërinë e organeve te vetëqeverisjes ne njesine tone. "Fuqizimi i vetëqeverisjes dhe procesit të decentralizimit me qëllim që të sigurohet

Bashkia Himare; Deklarata e Misionit Strategjik

një efikasitet më i lartë vetëqeverisës”, është vizioni që ndjek parimet dhe standardet e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore dhe parimet e Hapësirës Administrative Evropiane për qeverisjen vendore.

- *Politikat, objektivat dhe masat për zbatimin e strategjisë së decentralizimit* -jane përparësitë, objektivat dhe masat e miratuara nga të gjithë faktorët për ecjen përpara në procesin e reformës së decentralizimit. Ky synim, paraqet fazat kryesore të zbatimit : a) fazën e menjëhershme, në të cilën identifikohen dhe fillonë reforma dhe veprime afatshkurtra; b) faza e ndërmjetme deri në 2018, në të cilën do të realizohen elementët kryesorë të kuadrit ligjor; c) faza e tretë dhe e fundit deri në 2020, në të cilën do të plotësohet e gjithë gama e përgjegjësive dhe autoritetit të vetëqeverisë vendore. *Qëllimi kryesor dhe përfundimtar i reformës territoriale është rritja e efikasitetit të administratës së Bashkisë, cilësisë dhe standardeve të ofrimit të shërbimeve si dhe zhvillimi i drejtë i territorit duke mundësuar burime më të mëdha njerëzore dhe financiare, duke shtuar përgjegjësitë dhe kompetencat e strukturave në nivel njesie dhe duke u orientuar drejt një vendimmarrjeje më transparente dhe më shumë pjesëmarrje komunitare.*

Konsolidimi administrativ dhe financiar

-Bashkia Himare mbanë përgjegjësi të plotë për menaxhimin e burimeve njerëzore, të kapitalit të saj si dhe atyre financiare brenda territorit që ka. Në këtë drejtim, është e nevojshme që të kryhet vlerësimi dhe inventarizimi gjithëpërfshirës për gjendjen në secilën njesi aktuale, me qëllim që të krijohet një panoramë e qartë e funksioneve dhe detyrave të njësive që shkrihen dhe problemeve që duhen trajtuar në tërësi si dhe për të sqaruar specifikat që kanë të bëjnë me Bashkinë e zgjeruar. *Ky vlerësim administrativ dhe financiar do të jetë baza për krijimin e manualeve të funksionimit administrativ dhe profileve të reja të zhvillimit për bashkinë Himare. Synimi është që organet drejtuese të Bashkisë dhe njesitë administrative dhe organizative të kenë plotësisht në dispozicion të gjithë raportet dhe instrumentet e duhura.*

Bashkia Himare do të funksionojnë me një model të ri organizimi në territor, ku do të ketë në strukturën e saj; njësitë administrative, (ish-komunat Lukove dhe Hore). *Lidhja funksionale midis bashkisë dhe njësive të saj do të ketë mbështetje me asistencë teknike për ndërtimin e modeleve të organizimit institucional dhe administrativ brenda bashkisë si dhe mbështetje infrastrukturore për të bërë lidhjen fizike dhe virtuale midis tyre. Do të synohet që njësitë administrative të jenë mjaftueshmërisht funksionale për të garantuar një nivel të lartë të shërbimeve administrative në territorin e tyre.*

- *Burimet financiare si dhe ndikimi fiskal në kushtet për zbatimin e strategjisë* – do të jenë kërkesat për burimet financiare për zbatimin e strategjisë. Kërkesat për burime financiare për vitet 2016-2020 do të jenë baza për faktorët e zhvillimit për mbështetjen e zbatimit të strategjisë.

- *Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike. Ky sistem vendoset, ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësive dhe vihet në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësive do të arrihen nëpërmjet: a) veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi; b) pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme; c) informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota; ç) mbrojtjes së informacionit dhe të aktiveve të disponueshme të Bashkisë.*

- *Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi* – do të jete kuadri për monitorimin e ecurisë së arritur në zbatimin e veprimeve dhe performancës deri në përmbushjen e qëllimeve të strategjisë. Në këtë është dhe plani i veprimit për zbatimin e strategjisë, përfshirë këtu edhe afatin edhe përcaktimin e përgjegjësive për çdo veprim. Përveç kësaj, në të përfshihet një kuadër për vlerësimin e performancës të përbërë nga treguesit e monitorimit, treguesit bazë dhe të synuar, që do të përdoren për monitorimin e zbatimit të strategjisë sipas menaxhimit të bazuar në rezultate.

Misioni baze i njësive vendore, Bashkia Himare; është;

Bashkia Himare; Deklarata e Misionit Strategjik

- a-**Të rrisë efikasitetin në tërësi të strukturave drejtuese të Bashkise dhe të njesve perberese të saj. Në kuadrin e prioritetit kryesor të qeverisë për rishikimin e ndarjes administrative-territoriale, synimi i jone është konsolidimi territorial i njësive administrative perberse të Bashkise Himare.
- b-** Përparësi do t'i jepet ushtrimit të kompetencave në nivelin e strukturave të Bashkise dhe krijimin e strukturave të afta drejtuese e menaxheriale në bashkine e zgjeruar. Synimi do të jetë mbështetja për mirëfunksionimin e strukturave të zgjedhura (kryetari i bashkise dhe këshilltarët) si dhe administratorëve lokalë si strukturë e re që është krijuar bashke me të gjitha stafet e tyre.
- c-** Bashkia do të **forcojë financat vendore dhe do të rrisë autonominë e saj fiskale**. Shfrytëzimi i legjislacionit të decentralizimit fiskal që do të vazhdojë edhe më tej, do të krijojë mundësi që veteqeverisja vendore të ketë më shumë burime financiare, në mënyrë që të kryejë funksionet dhe kompetencat e saj në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme. Rritja e tardhurave të veta të Bashkise, një prioritet i pasesor.
- d-** Po ashtu rishikimi i planifikim-perdorimit me efikasitet të transfertave të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, duke siguruar transparencë dhe efikasitet si dhe bashkërendim me objektivat strategjike, do të nxisë zhvillimin me të qëndrueshëm në njesine të vendore.
- e-** Do të synohet ndërtimi i një modeli të ri të harmonizuar të zhvillimit social-ekonomik dhe territorial, duke synuar uljen e pabarazisë që egziston në zhvillim midis zonave dhe territoreve të Bashkise. Ky prioritet do të zbatohet nëpërmjet mbështetjes së Planeve Strategjike të Zhvillimit të zones, që do hartohet nga njësia jone vendore në përputhje edhe me politikat rajonale, (fshatit), të zhvillimit.
- f-** Për qeverisjen me të mirë në nivel vendor të Bashkise sone, përparësi do të ketë forcimi i transparencës dhe pjesëmarrjes së komunitetit, të biznesit dhe të shoqërisë civile në vendimmarrjen publike në nivel vendor. Kështu; do të ngrihet në njesine të një sistemi i veçantë për "monitorimin e performancës në nivel të njësive organizative dhe ato administrative" si mekanizëm për të garantuar llogaridhënien e administratës publike dhe efikasitetin e shërbimeve në nivel vendor.
- g-** Aktivizimi qytetar do të nxitet nëpërmjet fuqizimit të strukturave komunitare; (kryetarët e fshatrave dhe kryesitë e fshatrave). Përfshirja e rinisë në këto struktura komunitare do të jetë vendimtare për rritjen e aktivizimit qytetar. Prioritet do të jetë edhe rritja e përfaqësimit të grave dhe vajzave në strukturat qeverisëse si në nivel përfaqësues dhe në atë ekzekutiv. Në objektivat tona strategjike, gjithashtu do të nxitet përfshirja e minoriteteve në vendimmarrjen publike në të dhe forcimi i planeve të veprimit për respektimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve.
- h-** Qëllimi kryesor në ecurinë e zbatimit të reformës së administratës në Bashki do të jetë konsolidimi i një administrate vendore të çburokratizuar, të paanshme politikisht, profesioniste dhe transparente. Ajo do të jetë e gatshme t'i përgjigjet pritshmërive të komunitetit dhe biznesit për shërbime publike, e aftë që të përballojë sfidat e integritetit evropian dhe thithjen e fondeve të ndryshme, duke respektuar gjithmonë standardet, të cilët janë njëkohësisht edhe prioritetet e reformës së administratës publike në nivel vendor.
- i-** Përmirësimi i marrëdhënieve ndër-institucionale midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore si një prioritet tjetër i rëndësishëm dhe për të cilin do të ndërtohen mekanizmat formalë dhe funksionalë të dialogut ndër-institucional. Vendimmarrja me ndikim nga qeverisja qendrore do të jetë gjithëpërfshirëse dhe do të merret duke u konsultuar më parë me përfaqësuesit vendore. Do të forcohet bashkëpunimi institucional me shoqatat e të zgjedhurve vendorë dhe organizata të tjera të shoqërisë civile.
- j-** Në kuadrin e bashkëpunimit rajonal, njësia jone vendore do të kontribuojnë për forcimin e bashkëpunimit me njësitë fqinje dhe në kuadrin e programeve ndërkufitare dhe ndër rajonale.
- k-** Në fund të vitit 2020, në përmbushje të vizionit dhe objektivave strategjike, njësia jone vendore do kontribuojë në nivelin e mirëqenies dhe të zhvillimit të zones si dhe të procesit të integritetit evropian, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve cilësore publike për qytetarët dhe me standarte të përafuara evropiane. Qeverisja vendore kryen në mënyrë autonome të gjitha funksionet dhe kompetencat e përcaktuara qartësisht nga kuadri ligjor, brenda politikave të përgjithshme kombëtare, nëpërmjet burimeve të mjaftueshme financiare nga transfertat qeveritare dhe taksat e tarifave vendore.

Bashkia Himare; Deklarata e Misionit Strategjik

Në vitin 2020 njësia jone e qeverisjes vendore, Bashkia Himare; garanton qeverisje të hapur dhe transparente, me përfshirje të qytetarëve dhe komuniteteve, si dhe llogaridhënie bazuar në sisteme të besueshme të performances.

Shpenzimet dhe të ardhurat e Bashkise Himare; janë rritur në nivel të kënaqshëm çdo vit, pasi ato pothuajse janë trefishuar, krahasuar 5 vjet me perpara. Të ardhurat e veta në raport me shpenzimet publike kanë treguar ndjeshëm tendencë rritëse. Në vitin 2015 është kthyer tendencë rritëse e buxhetit vendor nga të ardhurat e veta, dhe po kështu edhe të rritjes së transfertave të pakushtezuara nga buxheti i shtetit si dhe të politikës së decentralizimit fiskal. Synimi do të jetë rritja progresive e këtyre treguesve.

Të ardhurat e veta; Struktura e të ardhurave të veta të Bashkise Himare, e ndryshuar rrënjësisht së fundi, në themel ka taksat e ndikimit në infrastrukturë e cila ka pësuar rënie shumë të madhe, ndërsa taksa e pasurisë së paluajtshme është kthyer në burimin më të fuqishëm megjithë pengesat e hasura për regjistrimet e pronës. Kjo taksë do të kthehet në burimin më të rëndësishëm të të ardhurave nga taksat vendore. Tarifat vendore janë një tjetër element i rëndësishëm i strukturës së të ardhurave vendore. Edhe mbledhja e penaliteteve financiare (gjobave etj.) është një burim tjetër financiar dhe po kështu, taksës së regjistrimit të mjeteve motorike, dhe të taksës për kalimin e të drejtës së pronës për pasurit e paluajtshme. Megjithatë, përballja me vështirësi në mbledhjen e taksave nga subjektet vjen edhe për shkak të mungesës së mekanizmave efikase për mbledhjen e tyre, çeshtje e cila do të jetë në synimet e njesive sone vendore në të ardhmen. Zhvillimet pozitive në drejtim të mbledhjes së taksave dhe rritjen se potencialit për të përmirësuar mbledhjen e taksës do të jetë misioni i njesive sone vendore.

Pronat vendore; Në misionin e Bashkise Himare do të jetë; Procesi i transferimit të pronës së paluajtshme tek njësitë vendore që është ende në vazhdim. Lista të inventarëve për transferimin e pronës janë të miratuara, ndërsa transferimi përfundimtar nuk është kryer. Ndërmarrja e ujësjellësit është transferuar tashmë tek njësi vendore në formën e aksioneve të shoqërive aksionere. Procesi i transferimit të pronës së pyjeve dhe kullotave nuk është përfunduar plotësisht për njësinë tone vendore.

Regjistrimi i tokës është duke ecur me ritme të ngadalta për shkak të shumë vështirësive me të cilat ballafaqohet ky proces, sic janë; problemet me hartat etj. Për këtë çështje është domosdoshme, një sistem të kompjuterizuar për inventarizimin e pasurive dhe të sistemit të informacionit GIS. Kjo bën të mundur që të kryhet një analizë më e mirë e informacionit dhe përdorimi i të dhënave për menaxhimin e pasurive të kryhet në përputhje me situatën specifike.

Bashkia ka të drejtë të shesë token prone të saj për zhvillimin e strehimit social etj. Ajo ka përgjegjësi për planifikimin urban, menaxhimin e tokës dhe strehimin duke krijuar e angazhuar fonde nga të ardhurat e veta, nga transfertat e buxhetit të shtetit, nga fondet e donatorëve apo të partneriteteve private-publike për programet e strehimit social, strehimit me kosto të ulët apo për infrastrukturën e tokës. Pas heqjes së kufizimeve të huamarrjes, përdorimi i PPP shihet si një mundësi e Njesive sone vendore për të stimuluar financimet private me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të infrastrukturës publike dhe aseteve vendore.

Bashkëpunimi ndërvendor

Do të përmirësohet; Bashkëpunimi ndër-vendor, si një mjet për të krijuar partneritet me njesive kufitare apo ato simotra vendore, me qëllim të respektimit të autonomisë vendore dhe të rritjes së fitimit nga burimet e kufizuara, që aktualisht është në fazë të hershme të zhvillimit. Aktualisht, administrimi i mbetjeve të ngurta të Bashkise dhe zhvillimi ekonomik janë dy fushat funksionale që bashkojnë natyrshëm një sërë njësish të qeverisjes vendore për të marrë pjesë në bashkëpunimin ndërvendor. Ka projekte të tilla; si për menaxhimin e ujësjellësit, administrimin e territorit dhe lejet e ndërtimit, ndërkohë që nuk ka pothuajse asnjë përvojë të këtij bashkëpunimi për shërbimet publike dhe shërbimet sociale, që tregon se ky bashkëpunim ndërvendor duhet të përdoret në mënyrë sistematike dhe strategjike.

Kapacitetet institucionale;

Bashkia Himare; Deklarata e Misionit Strategjik

Në kuadër të reformës së decentralizimit, përgjegjësitë e Bashkise janë bërë gjithnjë e më të rëndësishme dhe me të shumëllojshme. Përparimi i bërë, për sigurimin me efikasitet dhe përgjegjshmëri të shërbimeve cilësore publike në Bashki do marre përparësi të konsiderueshme në të ardhmen edhe në aspektin e kapaciteteve të burimeve institucionale.

Statusi civil i zyrtarëve publikë vendorë, që është ende i dobët, do të marre rëndësi dhe vlerën e duhur në përputhje me Ligjin e ri për Nënpunësin Civil. Kapacitetet e burimeve njerëzore të përmirësuar gjatë viteve të fundit, ka ende problematike që duhet kapërcyer. Kapacitetet e njësive të menaxhimit të burimeve njerëzore do të jenë të trajnuara e solide për të marre përparësi proceset e zhvillimit të Bashkise. Sistemi i pagave rregullohet nga kuadri ligjor specifik dhe kjo është e bazuar në një klasifikim në kategori në bazë të numrit të banorëve, fakt që nuk perkon me kapacitetet e burimeve njerëzore. Kapaciteti i kufizuar për të hartuar dhe zbatuar strategji të integruara të zhvillimit vendor, për hartimin e programit buxhetor vendor afatmesëm, aftësia për të trajtuar kompleksitetin rregullator dhe qëndrueshmërinë e strukturave të trajnimit janë disa nga sfidat kryesore për funksionimin e administratës vendore. Kapacitetet e duhura për fusha të ndryshme si menaxhimi i financave, statistikat, territori, prona, mjedisi, etj, janë në qëndër të misionit të njësive sone vendore.

Strukturat e qeverisjes vendore; Qëllimi kryesor i strategjisë do të jetë konsolidimi i autonomisë vendore nëpërmjet mbështetjes nga qeveria për funksionimin me efikasitet të strukturave përfaqësuese të saj, ekzekutive dhe komunitare të qeverisjes vendore në të gjitha nivelet.

Objektivat tona specifike do të jenë: ● Forcimi i rolit vendimmarrës dhe monitorues të këshillit bashkiak ● Menaxhimi i strukturave bashkiake dhe lidhshmërinë. ● Mbështetja për funksionalitetin e njësive administrative përbërëse; ● Forcimi i dialogut midis qeverisë qendrore dhe qeverisë vendore. ● Mbështetja për strukturat komunitare në nivel vendor.

Ligji i ri organik për qeverisjen vendore përmban për herë të parë edhe parimin e decentralizimit asimetrik bazuar në parimin e subsidiaritetit. Njësia vendore, Bashkia Himare, ka kapacitete njerëzore dhe burime financiare të cilat i mundësojnë asaj të kërkojë decentralizimin e kompetencave të caktuara brenda funksioneve të përbashkëta apo dhe funksioneve të tjera që ushtrohen nga organet e qeverisë qendrore duke synuar ofrimin e shërbimeve në një standard edhe më të lartë.

Këshilli i bashkisë; Roli i këshillit bashkiak himare, në perspektivën e reformës administrativo-territoriale do të rritet përpjesëtimisht me rritjen e territorit dhe të popullsisë të bashkise së re të Himares. Përfaqësimi i qytetarëve dhe vendimmarrja efikase do të mbështetet me kanale të reja të komunikimit midis të zgjedhurve dhe vete zgjedhësve duke respektuar në maksimum parimet e një demokracie funksionale dhe përfaqësuese në nivel vendor. Roli i këshillit dhe këshilltarëve bashkiak do të forcohet si përçues i zërit dhe interesave të qytetarëve në vendimmarrjen lokale. Këshilli bashkiak si i vetmi organ i brendshëm kontrollues dhe monitorues i zbatimit të politikave nga ekzekutivi dhe administrata do të marrë një rol të ri në këtë drejtim duke forcuar kapacitetet e brendshme. Marrëdhëniet midis këshillit dhe kryetarit të bashkise do të përmirësohen duke synuar saktësimin e kompetencave të këshillit si organ përfaqësues dhe kryetarit si organ ekzekutiv dhe menaxherial. Gjithashtu do synohet që këshilli të jetë forum i demokracisë lokale duke garantuar një lidhje edhe më të fortë me strukturat komunitare dhe shoqërinë civile. Pjesëmarrja e vete qytetarëve në vendimmarrjen e këshillit bashkiak do të rritet nëpërmjet aktivizimit qytetar në politikën vendore. Do të synohet rritja e përfaqësimit të të rinjve dhe grave në këshillat vendore me deri në 50% të përbërjes së këshillit bashkiak.

Njësitë administrative; Reforma administrative rikonfiguron sistemin e strukturave të Bashkise, nëpërmjet krijimit të njësive administrative përbërëse që janë (ish-komunat Hore-Vranisht dhe Lukove) si pjesë funksionale e bashkise së re. Mbështetja për funksionimin e këtyre njësive dhe administratës përkatëse do të jetë një nga sfidat tona në periudhën afatmesme. Njësitë administrative pjesë e rëndësishme e bashkise së re do të jetë një pikë e shërbimit me një ndalesë për shërbimet administrative për qytetarët. Lidhja funksionale dhe komplementariteti me zyrtarët qendrore të bashkise së re do të mbështetet

Bashkia Himare; Deklarata e Misionit Strategjik

me programe dhe projekte të asistencës teknike. Njësitë administrative do të kenë funksionet e tyre të përcaktuara nga ligji organik dhe nga vendimet e këshillit bashkiak si dhe do të shërbejnë nga një administratë e vogël dhe efiçente. Aplikimi i teknologjisë së informacionit do të lehtësojë ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët në keto njesi. Administratorët lokalë do të jenë drejtuesit e njësitë administrative dhe do të jetë zyrtari më i lartë që do mbajë përgjegjësinë në emër të kryetarit të bashkisë për mbarëvajtjen e punëve në territorin e njësisë administrative.

Zhvillimi ekonomik vendor

Bashkia do të jetë aktor kryesor në mbështetjen e zhvillimit ekonomik të zones me kompetenca dhe instrumente konkrete që nxisin sipërmarrjen dhe investimet. Klima lokale e biznesit do të mbështetet me nisma konkrete dhe investime publike që lehtësojnë thithjen e investimeve nga biznesi. Promovimi dhe nxitja e klimës së biznesit do të jetë synim i vecantë i Bashkisë Himare.

Planë Strategjike të Zhvillimit

Bashkia Himare do të hartojë Planin Strategjik të Zhvillimit i cili do të jetë instrumenti kryesor planifikues për zhvillimin ekonomik vendor. Ai do të jetë në harmoni me planin kombëtar dhe rajonal të zhvillimit dhe do të jetë baza e planifikimit të investimeve publike nëpërmjet planeve të investimeve kapitale dhe do të shërbejë për orientimin e investimeve dhe të buxhetit të shtetit në njësinë tone të qeverisjes vendore.

Planifikimi urban, administrimi i tokës:

Planifikimi i territorit do të vazhdojë të jetë një funksion i Bashkisë. Në përputhje me planin strategjik të zhvillimit, bashkia do të hartojë dhe miratojë planin territorial. Ligji i ri për planifikimin e territorit i jep kompetencë bashkisë për hartimin dhe miratimin e planeve të zhvillimit të territorit dhe lejeve të zhvillimit. Në zbatim të reformës territoriale do të rishikohet plani ekzistues të zhvillimit të territorit. Nga Qeveria qendrore do të sigurohet, mbështetje financiare për Bashkinë për rishikimin e planeve vendore dhe bazën e të dhënave të krijuara për territorin, (sic është; popullimi i platformës GIS).

Në Financat Vendore, (te ardhurat e veta), do të rishikohet taksa mbi tokën urbane dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndertimet e reja, si edhe disa instrumente të tjera financiare (sic janë; taksa, tarifa, kontribute, etj.), me qëllim që të sigurohen burimet e duhura financiare për veteqeverisjen vendore. Ndryshimet e krijuara prej reformës administrative-territoriale shoqërohen me ndryshimin e organizimit të brendshëm të Bashkisë, në mënyrë që Financat të përshtaten me kërkesat e administrimit të një territori më të madh. Menjëherë pas ndryshimit dhe konsolidimit të kufijve territorialë, ngritja e strukturave të reja dhe metodologjive për riorganizimin e punës, do të bëhet përgatitja e planeve të punës. Ngritja e kapaciteteve të stafit përkatës të Bashkisë, si edhe të zgjedhurit e rinj, do të luajnë një rol kyç në zbatimin e legjislacionit, një rol që do të varet shumë në profesionalizmin dhe aftësitë e tyre.

Mbrojtja dhe zhvillimi i pyjeve, kullotave dhe burimeve natyrore

Është decentralizuar 100% funksioni i pyjeve dhe kullotave dhe bashkia aktualisht, është aktori kryesor për menaxhimin e tyre si aset ekonomik por edhe mjedisor. Transferimi i pyjeve dhe kullotave do të përfundojë brenda vitit 2019. Bashkia përfshihet në zbatimin e një programi të ri pyllëzimi kombëtar dhe do të organizohet dita kombëtare e mbjelljes së pyjeve. Do të rritet bashkëpunimi mes shërbimit këshillimor bujqësor në qendër të Bashkisë, në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e qeverisë vendore në procesin e hartimit të politikave dhe të menaxhimit të zonave pyjore. Do të miratohet një program i ri investimi për të rehabilituar sa më shpejt të jetë e mundur, zonat pyjore me rëndësi kombëtare.

Turizmi

Pasuria e burimeve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore janë potencialet e përbashkëta për zhvillimin e turizmit. Turizmi është një sektor shumë i rëndësishëm për ekonominë tone vendore dhe ka një potencial të lartë për krijimin e vendeve të reja të punës. Bashkia ka kompetencat e plota në drejtim të organizimit të rrjetit të promovimit turistik lokal dhe rritjes së cilësisë së infrastrukturës lokale në shërbim të turizmit. Bashkëpunimi me institucionet përkatëse qendrore si dhe bizneset private për rritjen e sektorit të turizmit në nivel lokal do të jetë detyrim për bashkinë. Bashkia do të përfshihet për të përfituar nga zbatimi i tre

Bashkia Himare; Deklarata e Misionit Strategjik

programeve kryesore që planifikon të zbatojë qeveria: (a) Programi për Turizmin Kulturor dhe Historik, (b) Programi për Ekoturizmin dhe, (c) të Programit për Turizmin Bregdetar dhe Malor, i cili do të pasohet nga projekte të mëdha të investimeve kapitale në shërbime dhe infrastrukturë, përmes praktikave të partneritetit publik-privat, sidomos për zonat që janë afër zonave të banuara.

Mbrojtja kundra zjarrit, shpëtimit dhe Mbrojtja Civile

Bashkia ka marrë si funksion i vete, funksioni i shërbimit të mbrojtjes kundra zjarrit në nivelin lokal. Ndryshimet ligjore lejojnë që brenda vitit 2018, do të ristrukturohet PMZNSH-ja të transferuara tashme tek bashkia të organikave dhe strukturave të PMZNSH-së. Ky funksion i Bashkise do të shoqërohet edhe me transferimin e burimeve financiare dhe ngritjen e kapaciteteve. Strategjia dhe ligji i ri për mbrojtjen civile do të përmirësojë kompetencat dhe rolin e Bashkise në fushën e mbrojtjes civile.

Policia bashkiake

Kapacitetet e Bashkise do të forcohen përmes trajnimit të ofruar për inspektorët e policisë vendore për fusha të ndryshme që kanë të bëjnë me kompetencat e tyre. Strukturat e policisë bashkiake do të rishikohet në bazë të organizimit të ri të Bashkise pas ndarjes territoriale dhe administrative. Numri i stafit do të optimizohet në bazë të kriterëve të përcaktuara. Bashkia do të ofrojë mbështetje për zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës së emergjencës civile dhe për ngritjen e kapaciteteve të stafit.

Arsimi parauniversitar

Bashkia do të vazhdojnë të ketë të njëjtin funksion në këtë fushë. Do të hartohet një formulë e re për njësi/nxënës. Do të hartohen standardet minimale për mirëmbajtjen, sigurinë dhe performancën shëndetësore në qendrat e arsimit parauniversitar. Përcaktimi i kostove dhe standardeve minimale do të përmirësojë shpërndarjen e burimeve, e cila do të ndihmojë këshillin Bashkiak për të vendosur për fondet, bazuar në politikat për përmbushjen e atyre standardeve që janë me interes të zones.

Do të rishikohet me mire ndarja e përgjegjësisë dhe mekanizmave të llogaridhënies. Do të eliminohen mbivendosjet dhe paqartësitë nëpërmjet rishikimit dhe harmonizimit të legjislacionit aktual sidomos për qartësimin e kompetencave mes Bashkise dhe DAR/ZA për shpërndarjen e nxënësve brenda zonës së juridiksionit të njësive vendore. Do të krijohen mekanizma të reja për të forcuar rolin e drejtuesve të rinj vendorë në këshillat e institucioneve arsimore dhe për të përmirësuar marrëdhëniet mes drejtuesve të institucioneve arsimore dhe Bashkise si veteqeverisje vendore. Fondet e akorduara nëpërmjet granteve konkurruese për infrastrukturën e arsimit fillor dhe parauniversitar do të rriten dhe shpërndarja e tyre do të bëhet nëpërmjet një sistemi transparent.

Në kuadrin e programit “shkollat si qendër komunitare” bashkia do të jetë autoriteti kryesor në zbatimin e këtij programi nëpërmjet instrumenteve dhe veprimtarive me institucionet arsimore.

Asistenca sociale, zbutja e varfërisë dhe garantimi i funksionimit të institucioneve përkatëse

Objektivi kryesor është garantimi i një roli kryesor të Bashkise në shërbimet sociale dhe ndihmën ekonomike. Bashkia është përfshirë në zbatimin e Programit të Ri-integrimit Social dhe aplikimin e “Punë në vend të Asistencës Sociale”. Do të reformohet administrimi i Programit të Ndihmës Ekonomike me qëllim që të rritet efikasiteti dhe transparenca e sistemit. Përmirësimi i veprimtarisë së Fondit Social dhe krijimi i një Fondi Kombëtar për Shërbime Sociale dhe Fondet Rajonale për Shërbimet Sociale do të kontribuojnë në rritjen e burimeve financiare.

Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor

Bashkia ka një rol të kufizuar në zbatimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Ndikimi i zbatimit aktual nga Bashkia të funksioneve të përbashkëta në sistemin e kujdesit shëndetësor parësor si rrjedhojë e reformës administrativo-territoriale do të rishikohet për të sqaruar rolin dhe përgjegjësinë institucionale për mirëmbajtjen e infrastrukturës fizike të institucioneve të kujdesit shëndetësor parësor, të cilat janë pjesë e aseteve në pronësi të Bashkise Himare. Kompetencat e Bashkise, lidhur me programe të ndryshme të shëndetit publik, të tilla si HIV, lufta kundër duhanit, etj., do të përcaktohen qartë, si dhe do të hartohen standardet e shërbimit dhe të kostos për njësi.

Bashkia Himare; Deklarata e Misionit Strategjik

Rendi publik dhe siguria civile

Vëmendje do t'i kushtohet eliminimit të dublikimit të funksioneve ndërmjet policisë së shtetit dhe policisë bashkiake në kontrollin e trafikut urban në territorin e Bashkise Himare, për të siguruar harmonizimin e plotë të legjislacionit me policinë e shtetit tek qeverisja vendore. Ndërtimi i një partneriteti efektiv dhe të qëndrueshëm mes Policisë së Shtetit, dhe institucionit të Bashkise, shoqërisë civile dhe komunitetit është një nga prioritetet tona. Ky prioritet do të zbatohet nëpërmjet praktikave të institucionalizuara të bashkëpunimit dhe do të përcaktohet e zbatohet bashkërendimi mes Bashkise dhe Policisë së Shtetit në kryerjen e funksioneve të përbashkëta në mbrojtjen e rendit dhe të sigurisë publike.

Mbrojtja e mjedisit

Bashkia ka rol të përcaktuar në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Kompetencat kryesore janë të përcaktuara në ligjet sektoriale të menaxhimit të mbetjeve, të mbrojtjes së mjedisit, të mbrojtjes së cilësisë së ajrit etj., Kompetencat e bashkise në planifikimin dhe në mbikëqyrjen e mbrojtjes së mjedisit do të forcohen nëpërmjet mbështetjes për ngritjen e kapaciteteve. Është domosdoshmëri ngritja e strukturave adekuate dhe funksionale në Bashki për mbrojtjen e mjedisit, ku aktualisht kjo ka qënë lënë jashtë vëmendjes.

Funksionet e tjera, Funksionet e deleguara

Bashkia, është e angazhuar për t'i dhënë fund menaxhimit kaotik të regjistrimit civil dhe sistemit të adresave, përmes zbatimit të projekteve konkrete, që më në fund do të sjellin si rezultat një menaxhim të saktë të adresave dhe të regjistrimit civil, duke siguruar menaxhim të unifikuar të të dhënave të qytetarëve.

Zhvillimi i kapaciteteve të qeverisjes vendore

Fuqizimi i administratës të Bashkise është qëllimi kryesor në ecurinë e reformës së administratës publike. Prioriteti është të krijojmë një administratë publike të paburokratizuar, profesionale dhe transparente, politikisht të paanshme, të aftë për t'iu përgjigjur pritshmërive të biznesit dhe komunitetit për shërbimet publike, e gatshme për t'iu përgjigjur sfidave të integritimit evropian të vendit dhe thithjes së fondeve të BE, në respekt të plotë të standardeve, si prioritet kryesor i kësaj reforme.

Strukturat e bashkise së re do të rishikohet në mënyrë që të përshtatet me ndryshimet e reja, për të siguruar koherencë të mirë mes politikave të hartuara dhe të zbatuara në nivel vendor. Përveç kësaj, do të rishikohen funksionet mes Bashkise si njësi e dekoncentruar dhe Qarkut, në mënyrë që të eliminohen mbivendosjet dhe për të rritur përgjegjshmërinë.

Kapacitetet e njësive të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (MBNJ) në Bashki, do të forcohen në mënyrë që të sigurohet një zbatim i drejtë i ligjit të ri për shërbimin civil, përfshirë rekrutimin dhe sistemin e vlerësimit të performancës, duke krijuar një lidhje të fortë me vlerësimin individual të performancës. Kapacitetet duhen formuar për të lidhur më mirë MBNJ dhe Sistemin e zhvillimit të kapaciteteve me planet strategjike të zhvillimit vendor.

Performanca e kërkuar dhe kapaciteti adekuat i administratës së Bashkise do të arrihet përmes promovimit të të mësuarit të vazhdueshëm dhe trajnimeve afatshkurtër dhe afatgjatë. Zhvillimi në këtë Njese do të vijë në bashkëpunim edhe duke u rritur kapacitetet e Shkollës së Administratës Publike (SHAP), si një institucion strategjik për zhvillimin e kapaciteteve të punonjësve, për ofrimin e trajnimit të administratës vendore në bashkëpunim me ofrues të tjerë të trajnimit. Do të krijohen mekanizma efikase të komunikimit midis Bashkise dhe DAP, SHAP dhe shoqatave komunitare vendore për të përcaktuar kurrikulat e trajnimit bazë për zhvillimin e kapaciteteve të administratës së re vendore.

Baza e të dhënave MBNJ do të krijohet në Bashkinë e re, si pjesë e Sistemit të Informacionit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), dhe SIMBNJ do të lidhet me Sistemin Informativ Financiar të Qeverisë në kuadër të ndërveprimit të bazave të të dhënave të qeverisë, duke siguruar një menaxhim më efektiv të sistemit të financave publike në fushën e pagave në nivel vendor.

Qeverisja e hapur, transparencja, llogaridhënia, e-qeverisja në nivelin vendor

Qeverisja vendore, në Bashki do të jetë një qeverisje të hapur me orientim nga qytetarët. Parimet e qeverisjes së hapur, transparencës dhe llogaridhënies do të jenë parime të detyruara për tu aplikuar nga

Bashkia Himare; Deklarata e Misionit Strategjik

Bashkia Himare. Të gjitha vendimet në nivel vendor, ne Bashkine Himare, do të synohet të merren me pjesëmarrjen e qytetarëve në mënyrë transparente. Llogaridhënia në nivel vendor do të nxitet edhe nëpërmjet zbatimit të sistemeve të menaxhimit të performancës, që do të jenë instrumente objektive në transparencën dhe llogaridhënien e vete Bashkisë përpara komunitetit.

Ndërlidhja e databazave kombëtare me ato lokale do të lejojë shkëmbimin më të mirë të të dhënave dhe uljen e procedurave burokratike në aksesin e të dhënave. Veteqeverisja si instrument i modernizimit të shërbimeve publike do të aplikohet në nivelin vendor nëpërmjet zyrave unike të shërbimeve. Brenda vitit 2018 në të gjithë territorin e bashkisë dhe njësitë administrative të saj do të jenë të instaluarat zyrat unike të shërbimeve (one stop shop) të cilat do të garantojnë ofrimin e shërbimeve të modernizuara dixhitale për qytetarët pa pasur nevojë për marrjen e këtyre shërbimeve në qender të bashkisë.

Infrastruktura vendore dhe shërbimet publike

Në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve

Sektori i ujësjellës-kanalizimeve në Bashkine Himare, do të nënshtrohet një reformimi tërësor. Në periudhën afatmesme i gjithë kuadri rregullator dhe financiar do të rishikohen duke synuar që të vendoset standarde të reja në sistemin e prodhimit të ujit të pijshëm, shpërndarjes së tij dhe menaxhimit të ujërave të ndotura. Rivlerësimi i sistemit të tarifave të ujit do të bëhet në kuadrin e vlerësimit financiar të të gjithë sektorit. Krijimi i një legjislacioni për shërbimet publike/ndërmarrjet publike do të jetë prioritet afatshkurtër. Në kuadrin e reformës administrative ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve dhe asetet e saj në Bashki, do të nënshtrohen rikonfigurimit/bashkimit të tyre sipas njesive administrative.

Infrastruktura rrugore

Në drejtim të infrastrukturës rrugore do të synohet rritja e kapaciteteve menaxhuese për mirëmbajtjen e rrugëve urbane dhe rurale. Brenda vitit 2017 do të përfundojë inventarizimi i të gjithë sistemit të rrjetit rrugor urban dhe atij rural. Në nivel qendror nga qeveria, do të miratohen standardet e projektimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore. Format e PPP-ve në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës vendore do të nxiten si mjet efikas për rritjen e cilësisë së shërbimit.

Mbetjet urbane

Në bazë të reformës administrative-territoriale, do të rishikohet funksioni i menaxhimit të mbetjeve urbane. Sistemi i menaxhimit të integruar të mbetjeve do të funksionalizohet në kuadrin e bashkisë së re. Menaxhimi i landfillit do të rikonsiderohet në kuadrin e ri të kompetencave midis njesive të ndryshme të qeverisjes vendore, Bashkite kufitare dhe pjesmarrse të landfillit. Sistemi i tarifave të mbetjeve urbane do të synojë të nënshtrohet rregullave të mbrojtjes së konsumatorit duke synuar që standardizimi i formulës së përcaktimit të tarifave të bëhet nga një ent i pavarur shtetëror.

Do të miratohen standardet e reja dhe do të zbatohen ato për administrimin e integruar dhe menaxhimin e mbetjeve urbane me anë të përdorimit të mekanizmave ekonomike për të inkurajuar ndarjen dhe mbledhjen e diferencuar të mbetjeve në burim. Do të nxitet riciklimi i mbetjeve si një përpjekje për të ulur depozitimin e mbetjeve dhe për të mundësuar djegien e tyre me qëllim prodhimin e energjisë elektrike. Bashkia do të inkurajë aplikimin në formë të partneritetit dhe bashkëpunimit publik-privat dhe do të japë mbështetje me të fortë për finalizimin dhe miratimin e të gjitha planeve rajonale për një menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve, duke monitoruar edhe zbatimin e tyre.

Investimet kapitale në infrastrukturë

Investimet në Bashkine Himare, do të inkuadrohen në programe strategjike të zhvillimit rajonal të cilat garantojnë kohezionin ekonomik dhe social midis zonave të ndryshme të vendit. Për këto Bashkia do të mbështetet nga agjencitë e specializuara shtetërore në rritjen e kapaciteteve menaxhuese të projekteve të mëdha infrastrukturore, në menaxhimin e projekteve me financim të BE-së si dhe PPP-ve.

Ujitja dhe kullimi

Në fushën e infrastrukturës së bujqësisë, si funksion i ri në Bashki, decentralizohet funksioni i ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit dytësor dhe terciar të ujitjes dhe kullimit. Ky funksion i ri i Bashkisë do të rrisë

Bashkia Himare; Deklarata e Misionit Strategjik

dukshëm shërbimet në favor të fermerëve dhe zhvillimit rural. Ndryshimet në ligjin organik dhe aktet nënligjore do të përfshijnë dhe këtë fushë. Planet e menaxhimit të sistemeve të ujitjes dhe kullimit do të hartohen për çdo njësi administrative edhe me dihmën e autoriteteve qendrore dhe të donatorëve.

Funksionet në fushën sociale, kulturore dhe sportive

Shërbimet sociale dhe të përkujdesit social

Funksioni i shërbimit social vendor, ka kaluar tashmë në kompetencë të bashkise. Në bashki do të krijohet zyra e integruar të shërbimit social dhe do të hartohet një “shportë e shërbimeve bazë” të cilat do të financohen nga fondet e veta të Bashkise dhe nga buxheti i shtetit. Në bashki do të hartohet Plani Lokal Social. Bashkia do të ofrojë shërbime shtesë në fushën e shërbimeve sociale dhe përkujdesjes shoqërore, përtej “shportës të shërbimeve bazë”. Financimi i këtyre shërbimeve shtesë do të bëhet nga buxheti i vete, për këtë mund të krijohet instrument financiar si p.sh., Fondi Social Lokal.

Përmirësimi i kapaciteteve menaxhuese dhe cilësisë së *shërbimeve sociale* në lidhje me jetimoret, qendrat ditore, shtëpitë e të moshuarve, etj., do të jetë pjesë e prioritetëve të Bashkisë në sektorin social. Reforma në shërbimet sociale do të lidhet ngushtësisht me rolin e ri të qeverisjes vendore. Bashkia do të jetë aktori kryesor në ofrimin e shërbimeve sociale në nivel vendor duke plotësuar një vakum të madh midis pritshmërisë së qytetarëve për shërbime sociale dhe kapaciteteve ofruese të qeverisë vendore.

Do të ndërmerren disa reforma konkrete duke u fokusuar në rritjen e profesionalizmit të punonjësve socialë dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Do të forcohen kapacitetet institucionale të Bashkise për të mundur të hartojmë dhe zbatojmë programe gjithëpërfshirëse dhe të integruara shërbimesh për individë dhe familjet në nevojë. Ofrimi i shërbimit do të bazohet në një listë të paracaktuara të shërbimeve dhe standardeve minimale që do të hartohen nga vete Bashkia dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Do të synohet rivitalizimi dhe rritja e bashkëpunimit dhe partneriteti me organizata jofitimprurëse për ofrimin e shërbimeve sociale.

Strehimi social, Rinia, Sporti, Kultura

Strehimi social do të reformohet në harmoni me strategjinë e re kombetare të strehimit. Bashkia do të nxite masat për të krijuar bashkëpunime me sektorin privat dhe/ose jofitimprurës për të siguruar një strehim të përballeshëm për shtresat në nevojë, duke ofruar lehtësi fiskale dhe troje publike për strehim social. Bashkia do të ketë plane 10-vjeçare të strehimit social dhe do të planifikojë fonde specifike për këtë funksion. Kapacitet e bashkise për administrimin e kërkesave për strehim social dhe menaxhimin e stokut të banesave sociale do jenë objektiv për të mbështetur në periudhën afatmesme.

Janë rritur kompetencat e Bashkisë në fushën e rinisë. Në zbatim të politikave kombëtare, Bashkia do të hartojë politikat e saj në fushën e rinisë. Në bashki do të krijohet Bordi Këshillimor Rinor dhe përfshirja e të rinjve në këshillat bashkiak do synohet të jetë në nivelin 20%.

Po kështu; Bashkia do të jetë aktori kryesor në rivitalizimin e infrastrukturës sportive dhe organizimin nga ana e saj të aktiviteteve sportive. Në bashkëpunim me MAS do të synohet një rritje të aktiviteteve sportive dhe shtim të ambienteve sportive përkatëse në dobi të komunitetit.

Ndersa qëllimi i qeverisë është të rrisë fondet e caktuara për Bashkinë; për nxitjen dhe krijimin e kushteve që mundësojnë turizmin dhe trashëgiminë kulturore, veprimtari të përgjithshme kulturore që krijohen dhe realizohen në nivel vendor, nga ana e saj, Bashkia do të mbështete projektet në ngritjen e një sistemi të integruar të zhvillimit të zones dhe objekteve të trashëgimisë kulturore. Do të qartësohen mekanizmat ligjorë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Rivitalizimi me investime i objekteve të trashëgimisë kulturore me rëndësi dhe marketimi kësaj trashëgimie do të jetë prioritet afatmesëm.

H a r t o i
Irakli Gjicali
Zv. Kryetar

U miratua nga Keshilli Bashkiak
ne mbledhjen e dates 11.01.2016
Thodhori Beja (Sekretar i Keshillit)